




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

| REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO |                                             |                                    |                                          |
|---------------------------------------------------------|---------------------------------------------|------------------------------------|------------------------------------------|
| ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT                              |                                             |                                    |                                          |
| NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE |                                             |                                    |                                          |
| DATA PERSHKUTIMIT: 8-10-2024                            |                                             |                                    |                                          |
| DATA E DËRMIT: 8-10-2024                                |                                             |                                    |                                          |
| Niveli Org.<br>Org. Jedin.<br>Org. Unit                 | Shif. klasit.<br>Klasit. Kod<br>Class. Code | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No | Nr. fletëve<br>Br. Stranica<br>No. Pages |
| 01                                                      | 410                                         | 1538                               | 3                                        |



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

ndërmjet

ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

dhe

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
Fakulteti Ekonomik

tetor 2024, Prishtinë



Memorandumi lidhet me:

Zyrën Kombëtare të Auditimit (në tekstin në vazhdim "ZKA"), adresa: rr. "Ahmet Krasniqi" 210, Prishtinë, përfaqësuar nga **Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme** (në tekstin e mëtejme: ZKA), si njëra palë, dhe

Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"- (në tekstin e mëtejme: "FE"), adresa: Rr. "George Bush", Nr.31, 10000 Prishtinë, përfaqësuar nga Driton Balaj, Dekan, si palë tjetër.

Mbështetur në nenin 12.1 të Ligjit Nr.05/L055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të auditimit (Gazeta Zyrtare nr.17/10 qershor 2016), palët nënshkruese pajtohen për thellimin e bashkëpunimit nën kushtet si në vijim.

### **Kushtet e Përgjithshme:**

Të bashkëpunojnë në implementimin e programit të praktikës profesionale për studentet e FE-së.

Të shkëmbejnë përvojën, informacione, udhëzime dhe praktika të mira me qëllim të rritjes së cilësisë së punës dhe mbështetjes të dyanshme në mes dy institucioneve.

### **Obligimet/Detyrimet e veçanta në mes palëve**

ZKA-ja pajtohet të pranoj programin e praktikës profesionale për studentë e FE-së.

Objektivi kryesor i këtij programi është që stafi profesional i ZKA-së të ndaj përvojat me studentët të cilët do të kryejnë këtë praktikë. Programi i praktikës për studentë u mundëson lidhjen midis njohurive të fituara gjatë studimeve dhe punës praktike në institucionet publike të pavarura (siç është ZKA).

ZKA-ja pajtohet që FE-ja të shpall konkursin për pranimin e praktikantëve me kohë të caktuar për një periudhë prej 3-6 muaj për praktikë në ZKA me një numër, jo me shumë se 20 studentë gjatë vitit.

FE-ja kryen përzgjedhjen e kandidateve për praktikë duke i dërguar listën finale ZKA-së me studentet që do e ndjekin praktikën profesionale.

ZKA-ja pajtohet që të ju ofroj punë praktike për studentet pa kompensim, si dhe të pajisë me vërtetim me rastin e kryerjes së praktikës profesionale.

Palët do të shkëmbejnë literaturë dhe informacion shkencor me interes për secilën palë dhe marrin përsipër t'i dërgojnë njëra-tjetrës botimet e tyre shkencore.



Palët do të zhvillojnë një bashkëpunim të gjithanshëm shkencor në fushat e ndryshme kërkimore-shkencore me interes të përbashkët.

Secila palë, një herë në vit, do t'i ofrojë palës tjetër ligjërues për mbajtjen e ligjëratave shkencore në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

### Hyrja në fuqi


Ky memorandum i bashkëpunimit hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët. Memorandumi mund të shfuqizohet nga secila palë me një paralajmërim me shkrim së paku tre (3) muaj para ndërprerjes së njëanshme.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi që do të quhen të nevojshme do të bëhen mbi bazën e pëlqimit të të dy palëve, të cilat për këtë nënshkruajnë aktet përkatëse.

Memorandumi nënshkruhet në katër (4) kopje, në të dy gjuhët zyrtare.


Ky Memorandum u nënshkrua në Prishtinë, më datë 8 tetor 2024.

Në emër të ZKA-së:



Vlora Spanca  
Auditore e Përgjithshme

Në emër të Fakultetit Ekonomik



Driton Balaj  
Dekan

